Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo
CAA
Nr. i prot. 2026/ZDP/308
Broj/Prot.No.
Faqe: Kopje: Data: 30/10/2026
Stranica/Pages Kopija/Copy Datum/Date
Hyrës/ulazno/in
Dalës/izlazno/out
Brendshëm/Interno/Internal
Prishtinë/Priština/Pristina

Nr. 06/ZDP/VE/2026
Datë: 30 tetor 2026

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.2, 15.1(f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, 4 qershor 2008), dhe nenit 13.1 të Rregullores së AAC-së nr. 3/2015 mbi tarifat e aeroportit ("Rregullorja"), datë 8 qershor 2015,

Duke vendosur sipas kërkesës së operatorit të aeroportit LKIA të ANP "Adem Jashari" me numër protokolli 2026/ZDP/267, të datës 12 tetor 2026, për ndryshimin e përkohshëm të pikës 6.3 të Programit Nxitës 2025–2029;

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës nxjerr këtë:

VENDIM

1. Aprovohet ndryshimi i përkohshëm i pikës 6.3 "Nxitja për stacionimin e aeroplanëve" të Programit Nxitës 2025–2029 të operatorit LKIA të ANP "Adem Jashari"
2. Teksti i ndryshuar i nxitjes 6.3 është shënjuar me 6.3 a) dhe është pjesë integrale e këtij Vendimi
3. Nxitja 6.3 a) zbatohet vetëm në sezonin dimëror 2026-2027 dhe përfundon më 27 mars 2027. Pas kësaj date zbatohen kriteret e nxitjes 6.3 të Programit Nxitës 2025–2029.
4. Operatori i aeroportit obligohet që ndryshimin e aprovuar ta zbatojë në mënyrë transparente, objektive dhe jodiskriminuese ndaj të gjitha kompanive ajrore që plotësojnë kriteret përkatëse.
5. Operatori i aeroportit obligohet të publikojë ndryshimin e aprovuar në faqen e tij zyrtare dhe të informojë AAC-në mbi zbatimin e tij.
6. Çdo ndryshim tjetër i nxitjes 6.3 a) dhe Programit Nxitës 2025-2029 duhet të aprovohet paraprakisht nga AAC-ja.
7. Kompanitë ajrore mund të ankohen në AAC lidhur me zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Më 12 tetor 2026, operatori LKIA i ANP "Adem Jashari"("operatori i aeroportit") ka dorëzuar në AAC propozimin për ndryshimin e përkohshëm të pikës 6.3 Nxitja për stacionimin e aeroplanëve për sezonin dimëror 2026-2027, nxitje kjo në kuadër të Programit Nxitës 2025-2029. Si arsyetim janë paraqitur presioni nga çmimet e karburantit, kërkesa më e dobët e udhëtarëve, paqëndrueshmëria gjeopolitike dhe pasiguria lidhur me vazhdimin e nxitjes qeveritare. Sipas operatorit, këto rrethana kanë ndikuar në anulimin e fluturimeve, kapacitetin e ulëseve dhe lidhshmërinë ajrore të kompanive ajrore që stacionojnë aeroplanë në aeroport dhe janë përfitues të kësaj nxitjeje.

Për shqyrtimin e kërkesës, AAC-ja ka marrë në konsideratë dokumentacionin e identifikuar në rekomandimin e datës 30 tetor 2026:

1. Kërkesa e LKIA-së e datës 12 tetor 2026 që mban numrin e protokolit 2026/ZDP/267;
2. Kërkesa përmes emailit e AAC- së për informata dhe sqarime plotësuese e datës 14 tetor 2026;
3. Përgjigjja me email e LKIA-së e datës 21 tetor 2026 dhe Nenin 6.3 të ndryshuar dhe të shenjuar si pika 6.3 a);
4. Analiza krahasuese e operimeve dhe ndikimit financiar;
5. Dëshmitë e konsultimit me kompanitë ajrore e datës 23 tetor 2026;
6. Numri i fluturimeve të planifikuara në krahasim me fluturimet e realizuara si dhe përqindja e anulimeve në periudhën mars-tetor 2026;
7. Propozimi final i produktit nxitës 6.3 a) i datës 27 tetor 2026 i cili përmban pikën g) në të cilën është sqaruar kërkesa e AAC mbi zbatimin e kritereve.

Në bazë të detyrave dhe përgjegjësive të AAC-së sipas nenit 15(f) të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil si dhe nenit 8 të Rregullores nr. 3/2015 për tarifat e aeroportit, AAC-ja ka bërë shqyrtimin e këtyre dokumenteve dhe:

KA KONSTATUAR SE:

- Kriteret e ndryshuara për përfitim të nxitjes 6.3 a) janë të qarta, relevante, objektive dhe transparente në përputhje me Nenin 8 të Rregullores;
- Lehtësimi i kritereve për këtë nxitje është i arsyeshëm duke marrë parasysh se kompanitë ajrore që stacionojnë aeroplanë bartin numrin më të madh nga dhe në ANP "Adem Jashari" dhe rrjedhimisht edhe rritja e kostove të operimit më së shumti ka ndikim tek këta operatorë për shkak të vëllimit të operimeve;
- Të dhënat mbështetëse mbi nivelin e anulimit të fluturimeve (18%), prej prillit deri në tetor 2026 vërtetojnë rrezikun e mëtejmë të reduktimit të operimeve duke marrë parasysh se trafiku ajror historikisht është më i ulët gjatë sezonit dimëror si dhe proporcionalitetin e pragjeve të propozuara prej 80% dhe 20%;
- Kompania ajrore që momentalisht ka të stacionuar aeroplanë ka bartur 30% të udhëtarëve gjatë vitit 2025 respektivisht 29% të udhëtarëve deri në tetor 2026 dhe anulimi i fluturimeve do të kishte ndikim negativ tek një pjesë e madhe e publikut që udhëton përmes ajrit;
- Kriteret e lehtësuara vlejnë vetëm për sezonin dimëror 2026-2027 dhe nuk ndryshojnë kriteret tjera të pikës 6.3, zbritjet e aplikueshme dhe as pjesët e tjera të Programit Nxitës 2025–2029;
- Konsultimi me përdoruesit është bërë në periudhën 12 deri 20 tetor 2026 dhe nuk është pranuar ndonjë koment nga ana e tyre;
- Dokumentacioni i dorëzuar nga LKIA është vlerësuar i plotë në përputhje me kërkesat e neneve 12 dhe 13 të Rregullores. Bazuar në analizën krahasuese të operimeve dhe ndikimit financiar, vlerësohet se LKIA do të vazhdojë të gjenerojë të hyra nga trafiku ajror edhe pas lehtësimit të dy kritereve të propozuara, duke kontribuar njëkohësisht në ruajtjen e nivelit të operimeve gjatë sezonit dimëror 2026-2027;
- Zbatimi duhet të jetë transparent, objektiv dhe jodiskriminues për të gjitha kompanitë që plotësojnë kriteret përkatëse;

Përmes korrespondencës elektronike të dt. 27 tetor 2026 AAC ka dërguar propozimin e LKIA për dijeni e komente te Departamenti Qendror për Partneritet Publiko Privat i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve propozimin final të programit nxitës. Në përgjigjen e dërguar më 28 tetor 2026, DQPP nuk ka dhënë ndonjë koment dhe ka udhëzuar AAC-në që të vazhdojë të ushtrojë përgjegjësitë e saj brenda kompetencave dhe autorizimeve të saj, duke marr parasysh edhe dispozitat nga Marrëveshja PPP-ANP.

Duke marrë parasysh se ndryshimi i propozuar nga operatori i aeroportit është një iniciativë transparente dhe mbështetje për kompanitë ajrore që stacionojnë aeroplanë në ANP "Adem Jashari" që të mbajnë sa më shumë që është e mundur numrin e planifikuar të operimeve gjatë sezonit dimëror përkundër presionit nga rritja e kostove, është i kufizuar në kohë (vlen për sezonin dimëror 2026-2027), është proporcional me arritjen e objektivit të synuar dhe i ofrohet të gjitha kompanive ajrore pa përjashtim, mund të përfundohet se, si i tillë, ky ndryshim i përkohshëm është në interes të përgjithshëm publik dhe mund të kontribuojë në ruajtjen e trafikut ajror.

Duke u mbështetur mbi këtë bazë ligjore, UD Drejtori i përgjithshëm ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 30 tetor 2026

Arianit Islami
UD Drejtor i përgjithshëm

Udhëzim mbi mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të kërkohet rishikim administrativ pranë Komisionit të Ankesave të AAC-së, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Iu dërgohet:

- Operatorit të ANP "Adem Jashari" LKIA
- Departamentit Qendror PPP, MFPT

Departamentit të Aviacionit Civil, MMPHI

Enclosure 2

Article 6.3 as amended: tracked changes against the original text

6.3A THE FIXED BASE OPERATION (FBO) SUPPORT INCENTIVE

This Article 6.3A applies during IATA Winter Season 2026/27 (WS 26/27) only. All other eligibility criteria, conditions and incentive discount levels of Article 6.3 remain unchanged.

The aim of this incentive is to support the commercial airlines which base at least 1 (one) aircraft and operate flights from/to PIA.

Eligibility Criteria are listed below:

a. This Incentive Program is only valid for the commercial airlines which operate scheduled flights from/to PIA as confirmed by the PIA Schedule Facilitation Unit.

b. The commercial airline shall use PIA as a base airport for at least 1 (one) of its aircraft of the specified type and capacity. The commercial airline shall submit the Declaration of Based Aircraft: Airlines intending to base aircraft at PRN must provide an official declaration specifying the number of aircraft they plan to station at the airport. This declaration must be submitted in writing to airport management in the form of an official note signed by an authorized representative of the airline.

   The declaration should include:

   - The number of aircraft intended to be based at PRN.
   - The aircraft type and registration details.
   - The intended start date of operations for each based aircraft.

c. The fixed-based aircraft must be of the same type throughout the operational period. Airlines can request to change the type of based aircraft during the IATA year must seek prior approval from the airport, which will be subject to the airport's discretion and operational capabilities.

d. To qualify as a based aircraft, the airline must ensure the completion of an average eighteen (18) weekly frequencies (TRNs) within the designated IATA year for each aircraft stationed at the airport in the operational period between 06:00-23:00 hrs Local Time (LT).

e. Airlines seeking to qualify for the Fixed-Based Operation Incentive in the subsequent year (Y+1) must meet the following criteria during the current year (Y):

   - Turnaround Maintenance Target: Maintain the total number of turnarounds (TRNs) operated in WS 26/27 at no less than 80% of the IATA WS 25/26 level with the fixed based A/C/s.
   - Load Factor Requirement: Maintain an average passenger load factor of at least 80% for all flights operated with the fixed-based A/Cs during year Y.

f. Airlines with based aircraft must adhere to the Operational Plan outlined in the Airport Master Schedule for their operations. To ensure efficient resource allocation and operational reliability at the airport:

   - A maximum cancellation rate of 20% of the total scheduled flights on the Master Schedule within IATA Winter Season 2026/27 is permitted.
   - Cancellations exceeding this threshold—unless attributed to force majeure events—will jeopardize the airline's eligibility for the full Fixed-Based Operation Incentive.

g. Airlines using this product in the season preceding or succeeding WS 26/27, the other season of the year will be qualified according to the unamended point 6.3 of the program while the WS 26/27 according to this amended 6.3A.

Technical Recommendation:

- Cooperation on Technical Offices and Support Infrastructure: The airport will offer discount in technical office rent and/or support infrastructure for the airline's technical teams. This provision is subject to:

  Airport Discretion: The decision to grant access is at the discretion of airport management.

- Availability of Space and Infrastructure: Space and facilities must be available at the time the airline expresses interest.
- Aircraft Branding and Representation: All aircraft based should be branded in accordance with the airline's identity, reflecting its values, standards, and reputation. This requirement enhances the visibility of the airline's presence at the airport, strengthens brand association with high-quality service, and aligns with the airport's commitment to fostering reputable partnerships.
- If an airline qualifies for the Fixed Base Incentive and introduces a New Route or Long-Haul service, it may apply for Marketing Support in accordance with the requirements outlined in Article 6.1(j) for New Routes and Article 6.4(f) for Long-Haul Route.To achieve our shared objectives of operational efficiency and passenger satisfaction, the Fixed Base Operator is required to maintain an OTP of at least 85% across all its operations within the IATA year.
- To achieve our shared objectives of operational efficiency and passenger satisfaction, the Fixed Base Operator is expected to maintain an OTP of at least 85% across all its operations within the IATA year. In case of a frequent lower OTP rate within the IATA year operation, LKIA reserves the right to address this case with the airline within the terms of this Incentive Program.

Fixed Base Operation (FBO) Incentive Scheme

Incentive Category	~~Year 1~~- Discount
Landing Fee – for the Fixed Based Operation	50%
Parking Fee – for the Fixed Based Operation	100%
Full GH Basic Package for the FBO, OR;	25%
Limited GH Basic Package for the FBO	50%